Marrëveshja e linjës së kredisë Nr.

Datë:

HUADHENËSI
Emri i Kompanisë: **MONEGO Shpk**
Numri i Regjistrimit: **810034463**
Adresa e Regjistruar: **Nazim Gafuri, Kati3, Nr.31 , Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**
E-mail adresa: **info@monego.com** Tel: **+383 38 777 888**

HUAMARRËSI
1. Përkufizimet
Emri, mbiemri:
Numri personal identifikues:
Adresa:
E-mail adresa: Tel:

1.1 Përkufizimet e mëposhtme dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje do të zbatohen gjatë gjithë kësaj Marrëveshje:
1.1.1 **Huamarrësi:** personi fizik identifikuar sipas kësaj Marrëveshje.
1.1.2 **Llogaria Bankare e Huamarrësit:** do të thotë çdo llogari bankare e Huamarrësit, identifikuar sipas kësajMarrëveshje përmes së cilës Huadhënësi mund ta transferoj huanë tek Huamarrësi.
1.1.3 **Kontaktet e Huamarrësit:** nënkupton adresën e vendbanimit dhe adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit mobil të deklaruar nga Huamarrësi në këtë Marrëveshje, përmes të cilit Huamarrësi pranon të kontaktohet dhe për të pranuar Njoftime dhe komunikime nga Huadhënësi.
1.1.4 **Degët:** nënkupton hapësirat e Huadhënësit dhe/ose të ndonjë prej partnerëve të tijtë autorizuar, nëpërmjet të cilëve Huadhënësi kryen veprimtarinë e tij; një listë të plotë të Degëve mund të gjendet në faqen e internetit të Huadhënësit: www.monego.com.
1.1.5 **Dita e Punës:** do të thotë çdo ditë në javë (përveç një të diele ose një festë publike në Republikën e Kosovës).
1.1.6 **Detyrimet:** do të thotë komisionet, tarifat dhe detyrimet e tjera në pajtim me Kushtet Specifike të Huasë (siç përcaktohet më poshtë, në faqen e internetit ose në Degët), dhe Listën e Çmimeve, që Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit në lidhje me këtë Marrëveshje.
1.1.7 **Marrëveshja:** nënkupton këtë Marrëveshje të Linjës së Kredisë të nënshkruar në mes të Huadhënësit dhe Huamarrësit me shkrim në Degë ose online nëpërmjet Mediumit të Qëndrueshëm, së bashku me Formularin e informatave mbi kredinë konsumuese, Kushtet Specifike të Huasë (siç përcaktohet më poshtë, në faqen e internetit ose në Degët), dhe Listën e Çmimeve.
1.1.8 **Mosmarrëveshjet:** nënkupton mosmarrëveshjet e përcaktuara në Nenin 16 të kësaj Marrëveshje.
1.1.9 **Disbursimi:** do të thotë çdo shumë e disbursuar ndaj Huamarrësit nga Huadhënësi në pajtim me këtë Marrëveshje, bazuar në një kërkesë të Huasë të paraqitur nga Huamarrësi.
1.1.10 **Kohëzgjatja:** do të thotë kohëzgjatja e kësaj Marrëveshje, siç përcaktohet në përputhje me Nenin 4 të kësaj Marrëveshje.
1.1.11 **Medium i Qëndrueshëm:** çdo medium (si Kodi SMS, e-mail, Llogari online) që lejon Huamarrësin të japë pëlqimin (d.m.th. të nënshkruajë Marrëveshjen, ndonjë nga ndryshimet e tij në mënyrë elektronike, të japë pëlqimin për çdo ofertë dhe korrespondencë të bërë nga Huadhënësi në e-mail ose në Llogarinë Online në lidhje me Marrëveshjen) dhe u lejon Palëve të ruajnë informacionin e dërguar dhe t'i dërgohen për një periudhë kohe në përputhje me qëllimet e informacionit që përmban, ta përdorë atë dhe ta riprodhojë me saktësi në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Të gjitha dokumentet e ofruara nga Huadhënësi tek Huamarrësi janë në një format të sigurt PDF i cili nuk lejon shtimin e kushteve shtesë, modifikimin ose heqjen e atyre ekzistuese.
1.1.12 **Rasti i Mos përmbushjes:** nënkupton rrethanat e përshkruara në Nenin 15 të kësaj Marrëveshje.
1.1.13 **Interesi:** nënkupton kamatën kontraktore që Huamarrësi duhet ta paguajë së bashku me kryegjënë dhe rrjedh për pagesë në të njëjtën kohë me arritjen për pagesë të kryegjësë (shumës kryesore).
1.1.14 **Norma e Interesit:** do të thotë përqindja e normës mbi kryegjenë që Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit si Interes; Po ashtu norma e interesit nënkupton normën e interesit të shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e aplikuar në bazë vjetore në shumën e aprovuar të kredisë Norma e interesit përcaktohet dhe llogaritet në përputhje me Kushtet Specifike të Huasë. Mënyra e llogaritjes është kamatë e llogaritur në nivel ditor.
1.1.15 **Norma Efektive e Interesit (NEI):** nënkupton koston totale të huasë, të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të huasë dhe e llogaritur sipas metodologjisë të përcaktuar me Rregulloren e Bankës Qendrore së Kosovës për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje për Institucionet Financiare Jo Bankare, të miratuar me datë 31 Janar 2019. Për diskontim do të përdoret numri aktual i ditëve (kalendarike) të muajit dhe viti me 365/366 ditë, përmes së cilës hyrjet e diskontuara të parasë së gatshme duhet të barazohen me daljet e diskontuara të parasë së gatshme dhe e cila i referohet kredive të dhëna nga Monego.
1.1.16 **Kostoja totale e kredisë për klientin** nënkupton të gjitha kostot, duke përfshirë: interesin, komisionet, taksat dhe çdo lloj tjetër të shpenzimeve që IFJB i kërkon klientit t'i paguajë, në lidhje me marrëveshjen/kontratën e kredisë; shpenzimet tjera të detyrueshme lidhur me marrëveshjen e kredisë apo nëse klientit nuk i ofrohet mundësia e përzgjedhjes së ofruesit të një shërbimi të tillë;
1.1.17 **Kamatëvonesa:**do të thotë kamata e kontraktuar në mes të Huadhënësit dhe Huamarrësit e cila aplikohet në rast se Huamarrësi vonon në përmbushjen e kthimit të huasë sipas kësaj Marrëveshje. Norma e interesit të kamatëvonesës dhe mënyra e llogaritjes së saj përcaktohet në përputhje me Kushtet Specifike të Huasë.
1.1.18 **Pagesa në Vonesë:** nëse huamarrësi dështon të kryejë pagesën me rregull, siç është caktuar me kushtet dhe afatet e marrëveshjes përkatëse të marrëveshjes kreditor, ndaj huadhënësit, pagesa është në vonesë dhe huamarrësi do të konsiderohet në vonesë.
1.1.19 **Huadhënësi:** do të thotë Monego Sh.P.K.(shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) Institucion Financiar Jo-Bankar (IFJB).
1.1.20 **Llogaria Bankare e Huadhënësit:** nënkupton çdo llogari bankare të Huadhënësit, të publikuar nga Huadhënësi në Ëebsite (siç përcaktohet më poshtë) dhe/ose në Degët.
1.1.21 **Shumat e Huasë:** do të thotë shumat e përgjithshme që janë disbursuar nga Huadhënësi, të cilat duhet të kthehen në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me Kushtet Specifike të Huasë.
1.1.22 **Aplikimi për ndryshime në kredi:** do të thotë çdo aplikim me shkrim, në formatin e miratuar nga Huadhënësi, të bëra nga Huamarrësi në Degët ose në mënyrë elektronike përmes llogarisë online, për ndryshimin e kushteve origjinale të shumave tashmë të disbursuara.
1.1.23 **Aplikimi i Huasë:** do të thotë çdo aplikim me shkrim, në formatin e miratuar nga Huadhënësi, të bëra nga Huamarrësi në Degët ose në mënyrë elektronike përmes llogarisë online, për disbursimin e Shumave të Huasë deri në Limit ose për rritjen e Limitittë miratuar paraprakisht nga Huadhënësi.
1.1.24 **Tarifa e zgjatjes së afatit të Huasë:** Tarifa për zgjatjen e afatit të datës së pagesave.
1.1.25 **Afati i zgjatjes së huasë:** afati (-et) i zgjatjes së datës së pagesave.
1.1.26 **Tarifa e lëshimit të Huasë:** Komisioni i pagueshëm nga Huamarrësi tek Huadhënësi për lëshimin e huasë.
1.1.27 **Limiti:** nënkupton shumat e përgjithshme të miratuara nga Huadhënësi, deri në të cilën Huamarrësi lejohet të ketë Shuma të Kredisë të papaguara në çdo kohë të caktuar. Limiti nuk përfshin asnjë shpenzim për mirëmbajtje të Kredisë.
1.1.28 **Njoftimet:** do të thotë njoftimet dhe komunikimet ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje, në përputhje me Nenin 14 të kësaj Marrëveshje.
1.1.29 **Llogaria Online:** do të thotë një llogari online e konsumatorit e përcaktuar në Nenin 12 të kësaj Marrëveshje.
1.1.30 **Afatet dhe Kushtet e Llogarisë Online:** do të thotë kushtet e miratuara nga Huadhënësi, që rregullojnë mirëmbajtjen dhe funksionimin e llogarisë online;
Huadhënësi publikon në faqen e internetit një version të përditësuar që është në fuqi, të Afateve dhe Kushteve të Llogarisë Online dhe çdo ndryshim në Afate dhe Kushtet e Llogarisë Online, do t'i njoftohet Huamarrësit për pëlqimin nëpërmjet Llogarisë Online, në përputhje me Nenin 14 të kësaj Marrëveshje.
1.1.31 **Shumat e papaguara:** do të thotë shumat e përgjithshme që Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshje, e cila përfshin Shumat e Huasë, Interesat dhe Tarfiat (Komisionet) të përcaktuara me Kushtet Specifike të Huasë.
1.1.32 **Palët ose Pala:** do të thotë Huadhënësi dhe/ose Huamarrësi, bashkërisht ose ndaras sipas rastit.
1.1.33 **Orari i Pagesave:** nënkupton kushtet për ripagimin ose pagesën e çdo Shume të Huasë dhe të Interesit, sipas një Kërkese për Hua, sipas gjendjes ekzistuese që ndodhet në fuqipasi ajo mund të ndryshohet në përputhje me një Kërkesë për Ndryshim të Huasë të aprovuar nga Huadhënësi.
1.1.34 **Data e pagesave:** do të thotë datat e caktuara për kthimin nga Huamarrësi për çdo Shumë të Huasë, ose për pagesën e ndonjë Interesi dhe/ose Detyrime, në përputhje me një Plan të Pagesave ose për një afat tjetër pagese të prezantuar në këtë Marrëveshje.

1.1.35 **Rregullore e Privatësisë:** nënkupton rregullat e miratuara nga Huadhënësi, duke përmbajtur Afatet dhe Kushtet për trajtimin e të dhënave personale të Huamarrësit. Huadhënësi publikon në faqen e internetit një version të përditësuar të Njoftimit të Privatësisë dhe çdo ndryshim në Njoftimin e Privatësisë e cila është në përputhje me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do t'i njoftohet Huamarrësit për pëlqim nëpërmjet Llogarisë Online, sipas Nenit 14 të kësaj Marrëveshje. Njoftimi i Privatësisë është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.
1.1.36 **Njoftimi për Korrigjim:** do të thotë njoftimi i referuar në Nenin 15 të kësaj Marrëveshje.
1.1.37 **Programi i Interesit dhe Detyrimeve:** do të thotë dokumenti i miratuar nga Huadhënësi, që përmban Normën e Interesit, Kamatëvonesën dhe Detyrimet, si dhe metodën përkatëse të llogaritjes; Huadhënësi publikon në faqen e internetit një version të azhurnuar në fuqi, të listës së interesit dhe detyrimeve, si dhe çdo ndryshim në listën e interesit dhe detyrimeve, i njoftohet Huamarrësit për pëlqim nëpërmjet Llogarisë Online, në përputhje me nenin 14 të kësaj Marrëveshje, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.
1.1.38 **Data e nënshkrimit:** do të thotë data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Huamarrësi dhe Huadhënësi, siç është cekur më lartë.
1.1.39 **Kodi i SMS-së:** do të thotë një kod 4-shifror SMS i konfirmimit dhe kodit të sigurisë të dërguar nga Huadhënësi në numrin e telefonit mobil të zotëruar dhe të regjistruar nga Huamarrësi si pjesë e Kontakteve të Huamarrësit siç përcaktohet me këtë Marrëveshje. Palët me këtë rast konfirmojnë dhe pranojnë se të gjitha veprimet e ndërmarra nga Huamarrësi të cilat konfirmohen, përveç nëse parashikohet ndryshe, me anë të një Kodi SMS, duhet të njihen si pëlqim eksplicit i dhënë nga Huamarrësi dhe Huamarrësi kupton dhe pajtohet që Huamarrësi është përgjegjës për të gjitha pasojat juridike që mund të lindin nga dhënia e pëlqimit në fjalë nëpërmjet SMS Kodi. Huamarrësi është i detyruar të mbajë kodin SMS të dërguar nga Huamarrësi sekret dhe të mos e bëjë atë të disponueshëm për palët e treta. Kodi i ri dhe unik i SMS-ve gjenerohet nga Huadhënësi me kërkesë të Huamarrësit duke klikuar një katror të caktuar në faqen e internetit dhe/ose llogarinë online dhe mund të dërgohet nga Huadhënësi te Huamarrësi në përputhje me Marrëveshjen. Duke klikuar kutinë e shënuar dhe duke futur Kodin SMS, Huamarrësi pajtohet me tekstin që tregohet pranë kutisë së kontrollit dhe çdo informacion tjetër që lidhet me veprimet e përcaktuara aty.
1.1.40 **Njoftimi i Përfundimit:** nënkupton njoftimin e përcaktuar në Nenin 15 të kësaj Marrëveshje.
1.1.41 **Website** nënkupton faqen e internetit të Huadhënësit, në ë www.monego.com

2. Interpretimi

2.1 Kjo Marrëveshje, përveç nëse një kuptim tjetër bëhet i dukshëm nga përmbajtja e dispozitës përkatëse, do të interpretohet si në vijim:
2.1.1 Kur bëhet një referencë në këtë Marrëveshje, një referencë i bëhet një neni, seksioni, paragrafi ose dokumenti, përveç nëse tregohet ndryshe, një referencë e tillë do të jetë në një nen, pjesë ose paragraf të kësaj Marrëveshje ose në një dokument tjetër të treguar në këtë Marrëveshje që gjendet në fuqi.
2.1.2 Titujt dhe nëntitujt e neneve, paragrafëve ose nënparagrafëve, të përfshira në këtë Marrëveshje, janë vetëm për qëllime reference dhe nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin ose interpretimin e dispozitës përkatëse.
2.1.3 Kurdo që fjalët "përfshijnë", "përfshin" ose "përfshirë" janë përdorur në këtë Marrëveshje, ato do të konsiderohen të pasohen me fjalët "pa kufizim".
2.1.4 Fjalët "për këtë", "në këtë mënyrë", "veç kësaj" dhe "prandaj" dhe fjalët e ngjashme kur përdoren në këtë Marrëveshje do t'i referohen kësaj Marrëveshje si tërësi dhe jo ndonjë neni, seksioni ose paragrafitë veçantë të kësaj Marrëveshje.
2.1.5 Referencat për një afat në "ditë" do të jenë një afat në ditët kalendarike, përveç rasteve kur nuk referohen në mënyrë specifike si Ditët e Punës. Një periudhë prej një ose më shumë ditë kalendarike ose Ditë Pune fillon respektivisht në ditën e ardhshme kalendarike ose Ditën e Punës.
2.1.6 Referencat për një afat në "javë", "muaj" ose "vite" do të llogariten nga data e deri në datën ("dita përkatëse"); në rast të kushteve të përcaktuara në "muaj", nëse muaji i fundit kalendarik i periudhës nuk ka "ditën korresponduese" deri në ditën e muajit kalendarik në të cilin ka filluar periudha, atëherë afati përfundon në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendarik të periudhës.
2.1.7 Afatet e përcaktuar janë të zbatueshme për format njëjëse poashtu edhe të formave shumëse të afateve të tillë.

3. Fushëveprimi dhe Qëllimi i Marrëveshjes

3.1 Në varësi të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, Huadhënësi me këtë pranon t'i japë hua Huamarrësit duke i dhënë Huamarrësit një linjë krediti, deri në shumën e Limitit, dhe Huamarrësi pranon të marrë hua nga Huadhënësi dhe kthimin e mjeteve të huazuara, si dhe pagesën e interesit dhe detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje si dhe anekset e saj.
3.2 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është ofrimi i huasë për qëllime (konsumi) personale të Huamarrësit.

4. Kohëzgjatja dhe Mjeti i Sigurimit të Marrëveshjes

4.1 Kjo Marrëveshje është përpiluar dhe do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi të plotë për një periudhë të pakufizuar kohore duke filluar nga data e nënshkrimit ("Kohëzgjatja"), përveç nëse kjo Marrëveshje përfundon në përputhje me Nenin 15.
4.2 Huamarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga kjo Marrëveshje pa dënime dhe pa u kërkuar të japë ndonjë arsye, duke dërguar një Njoftim me shkrim tek Huadhënësi jo më vonë se 14 (katërmbëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.
4.3 Pas marrjes së njoftimit për tërheqjen e Huamarrësit, Huadhënësi do të informojë Huamarrësin përmes një Njoftimi me shkrim për shumën që duhet të paguhet, e cila përfshin çdo shumë të disbursuar, interesin e përllogaritur për ditët përkatëse, shpenzimet administrative (tarifat) të pa paguara nga Huamarrësi si dhe kostot që Huadhënësi ka shkaktuar me palët e treta për miratimin dhe disbursimin dhe çdo shume të huasë nëse ka.
4.4 Nëse Huamarrësi dështon t'i paguaj shumat e lartpërcaktuara brenda një afati prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga Njoftimi i Huadhënësit, atëherë tërheqja e Huamarrësit nga kjo Marrëveshje nuk do të cenojë zbatimin e dispozitave të neneve 10,11, 14, 16, 18, 19 dhe 20 të kësaj Marrëveshje, të cilat do të mbesin aktuale në tërheqjen e Huamarrësit dhe dispozitat e të drejtës së tërheqjes nuk do të vlejnë pas kësaj date.
4.5 Kjo Marrëveshje sigurohet me mjetin e sigurimit të pengut konform Aneksit I të kësaj Marrëveshje.

5. Limiti

5.1 Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, Huadhënësi nëpërmjet njoftimit ia komunikon Humarrërsit limitin e aprovuar.
5.2 Huadhënësi, sipas vlerësimittë tij, ka të drejtë të reduktojë limitin me efekt të menjëhershëm, në rast se Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimine tij sipasMarrëveshjes, ose rrezikon një humbje të konsiderueshme/reduktim të të ardhurave të deklaruara në aplikimin për kredi dhe/ose në çdo vlerësim pasues të vlerës së kredisë që mund të bëhet nga Huadhënësi. Çdo reduktim në limit do t'i njoftohet Huamarrësit përmes një njoftimi me shkrim.
5.3 Huamarrësi ka të drejtë të paraqesë një ose disakërkesa për hua, duke kërkuar rritjen e limitit të miratuar paraprakisht nga Huadhënësi. Në rast të kërkesës për hua, Huadhënësi ka të drejtë të kërkojë nga Huamarrësi që të paraqesë çdo dokument që Huadhënësi e vlerëson të nevojshme. Huadhënësi disponon diskrecion të plotë në miratimin e kërkesës për rritje të limitit.
5.4 Pavarësisht nga çdo kërkesë e huasë, Huadhënësi do të ketë të drejtë dhe me këtë do të autorizohet nga Huamarrësi, sipas vlerësimittë tij, për të rritur një limit të miratuar më parë, në rast se Huamarrësi ka një histori krediti të mirë me Huadhënësin. Çdo rritje në Limit do t'i njoftohet Huamarrësit përmes një njoftimi me shkrim.

6. Disbursimet dhe Shlyerja

6.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, Huamarrësi ka të drejtë të paraqesë një osedisa kërkesa të huasë, deri në limit, dhe çdo shumë të tillë të disbursuar nga Huadhënësi do të titullohet"Shuma e Huasë".
6.2 Për çdo kërkesë të huasë të bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshje, Huamarrësi do të jetë përgjegjës për pagesën e tarifës së disbursimit të përcaktuar në Kushtet Specifike të Huasë.
6.3 Huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë tarifën e lëshimit të huasë dhe/apo shpenzimet e tjera administrative, ose ato mund të shtohen në kryegjënë e huasë (me të cilën llogaritet kamata) dhe pastaj të paguhen në kështet mujore në formën e aplikacionit të huasë.
6.4 Huadhënësi rezervon të drejtën të mos bëjë një disbursim nëse Huamarrësi njofton për ndërprerje të Marrëveshjes, dështon të përmbush obligimin ndaj Marrëveshjes apo rrezikon një humbje/zvogëlim të konsiderueshem të të hyrave të deklaruara në aplikacionin e kredisë, dhe/ose ndonjë vlerësim që mund të bëhet nga Huadhënësi. Huadhënësi gjithashtu rezervon të drejtën që të mos bëjë disbursim nëse Huamarrësi nuk ka pranuar versionin e fundit të Kushteve Specifike të Huasë. Huadhënësi rezervon të drejtën të mos bëj një Disbursim nëse Huamarrësi ka dështuar të ofrojë ndonjë informacion shtesë të kërkuar nga Huadhënësi, përfshirë por pa u kufizuar në foton e një dokumenti identifikues të vlefshëm dhe të pa-skaduar i cili mban fotografinë, dhe orgjinale e Huamarrësit dhe dokumenteve mbështetëse të Huamarrësit, si dhe dokumentet që provojnë datën e lindjes dhe/ose adresen e Huamarrësit, apo nëse Huamarrësi dështon të ofrojë përgjigje korrekte të ndonjë pyetje të sigurisë të kërkuara nga Huadhënësi për qëllim të konfirmimit të identitetit të Huamarrësit para disbursimit.
6.5 Disbursimet do të bëhen në para të gatshme në degët e Huadhënësit, ose nëpërmjet një transferimi bankar në Llogarinë Bankare të Huamarrësit, ose nëpërmjet një partneri tjetër të autorizuar të Huadhënësit. Lista dhe informacione shtesë lidhur me partnerët e përcaktuar do të jenë në dispozicion në faqen e internetit.
6.6 Pas një Disbursimi, Huamarrësi do të paguajë Shumën e Huasë në datat përkatëse të pagesës në pajtim me Kushtet Specifike të Huasë dhe Planin e Amortizimit.
6.7 Huamarrësi ka të drejtë që në çdo kohë dhe pa pagesë me kërkesë të tij të marrë një deklaratë të llogarisë gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Huasënë formë të Planit të Amortizimit.

7. Ristrukturimi i Huasë

7.1 Huamarrësi ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë një kërkesë për ndryshimin e kredisë për ndryshimin e kësteve të ripagimit dhe datat e pagesës në lidhje me një disbursim të mëparshëm.
7.2 Për çdo kërkesë të ndryshimit të huasë të bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshje, Huamarrësi do të jetë përgjegjës për pagesën e tarifës së lëshimit të huasë të përcaktuar në Kushtet Specifike të Huasëtë miratuara nga Huadhënësi gjatë kohës së aplikimit. Huadhënësi rezervon të drejtën për të mos miratuar ndonjë kërkesë për ndryshime të huasë, nëse Huamarrësi nuk ka pranuar versionin e fundit të listës së interesave dhe detyrimeve të Huadhënësit.

7.3 Huadhënësi ka të drejtë të kërkojë nga Huamarrësi që të paraqesë çdo dokument që Huadhënësi e vlerëson të nevojshëm në lidhje me një kërkesë për ndryshim të huasë dhe që miratimi i çdo kërkese për ndryshimin e huasë do të jetë në diskrecionin e Huadhënësit.
7.4 Çdo kërkesë e ndryshimit të huasë e bërë nga Huamarrësi, i cili është miratuar nga Huadhënësi, do të ketë efektin e zëvendësimit të kushteve të ripagimit të programit të mëparshëm të pagesave.Në këtë rast, Huamarrësi do të pajiset me planin e ri të pagesave ("Plani i Amortizimit").
7.5 Miratimi nga Huadhënësi i çdo kërkese huasë dhe/ose kërkesës për ndryshimin e huasë do t'i njoftohet Huamarrësit përmes një njoftimi me shkrim.
7.6 Huamarrësi mund ta zgjasë afatin e ripagimit të huasë deri në afatin zgjatës, ose ta ripërpilojë afatin e pagesës, duke paguar Tarifën e Zgjatjes së Afatit të Huasë, duke pasur parasysh që kryerja e pagesave sipas marrëveshjes së huasë nuk vonohet për më shumë se 30 ditë ose Marrëveshja nuk është shkelur.
7.7 Kushtet e Ristrukturimit të Huasë hyjnë në fuqi kur pagesa e Tarfiës eZgjatjes së Afatit të Huasë është pranuar nga Huadhënësi.
7.8 Nëse afati i ripagimit të kredisë zgjatet, gjatë kohës së zgjatjes Huamarrësi paguan Huadhënësin vetëm për Tarifën e Zgjatjes së Afatit të Huasë, por kryerja e pagesave të tjera të Marrëveshjes shtyhet konform Planit të Amortizimit.

8. Interesi dhe Detyrimet

8.1 Huamarrësi duhet të paguajë Huadhënësin interesin së bashku me kryegjënë në normën e përcaktuar sipas Kushteve Specifike të Huasë në fuqi në momentin e aplikimit të huasë dhe nënshkruar nga Huamarrësi ose sipas kërkesës për ndryshimin e huasë së aprovuar nga Huadhënësi. Interesi llogaritet sipas përcaktimit në Kushtet Specifike të Huasë.
8.2 Interesi do të paguhet nga Huamarrësi në Datat e Pagesës, në pajtim me Kushtet Specifike të Huasë dhe Planin e Amortizimit.
8.3 Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë Huadhënësit edhe Tarifat shtesë në përputhje me Kushtet Specifike të Huasë, në fuqi në momentin kur Detyrimi bëhet i zbatueshëm dhe nëse nuk është përcaktuar ndryshe, të gjitha Detyrimet duhet të paguhen nga Huamarrësi përpara çdo kërkesë që mund t'i bëhet Huadhënësit.
8.4 Huadhënësi mund t'i ofroj Humarrësit hua me 0% interes në raste të caktuara dhe nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me rregullat e brendshme të huadhënies së Huadhënësit. Kushtet dhe afatet për hua me 0% do të specifikohen në Kushtet Specifike të Huasë dhe Listën e Çmimeve.
8.5 Për çdo ndryshim të Tarifave Huamarrësi do të njoftohet një (1) muaj përpara se ndryshimi të hyj në fuqi.

9. Parapagimi i Huasë

9.1 Huadhënësi ka të drejtë të paguaj huanë në tërësi apo pjesërisht para afatit të pagesës. Në çdo rast, nëse Huamarrësi dëshiron të ushtroj të drejtën e tij të parapagimit të huasë, detyrohet që ta njoftojë Huadhënësin paraprakisht, së paku një ditë pune përpara ushtrimit të së drejtës.
9.2 Pasi Huamarrësi ushtron të drejtën e tij sipas paragrafit 1 dhe 2 të kësaj dispozite, Huadhënësit i takon e drejta në kompensim objektiv për pjesën e shlyer të huasë para afatit. Në këtë rast Huadhënësi do të zbatoj kompensim prej 0.5% mbi shumën e parapaguar të huasë në qoftë se periudha midis parapagimit dhe kohës për kthim të huasë është më pak se një (1) vit, ndërsa do të zbatoj kompensim prej 1% mbi shumën e parapaguar të huasë në qoftë se periudha midis parapagimit dhe kohës për kthim të huasë është mbi një (1) vit.

10. Kamatëvonesa e kontraktuar

10.1 Nëse Huamarrësi dështon të kthen shumën e huasë dhe paguan interesin, në përputhje me Kushtet Specifike të Huasë dhe/ose datën e pagesave dhe/ose për të paguar Detyrimet për Huadhënësin ("Shumat e papaguara") atëherë, Huamarrësi do të jetë përgjegjës t'i paguajë Huadhënësit kamatëvonesën të llogaritur në pajtim me Kushtet Specifike të Huasë, në fuqi në momentin e aplikimit.
10.2 Zbatimi i kamatëvonesës, nuk cenon të drejtën e Huadhënësit për ta filluar procedurën e përmbarimit në Nenin 19 të kësaj Marrëveshje, pa e anuluar këtë Marrëveshje dhe/ose ta ndërpresë këtë Marrëveshje sipas Nenit 15 më poshtë.
10.3 Llogaritja e ditëve të vonesës. Huadhënësi i lejon Huamarrësit një periudhë tolerimi prej tri (3) ditësh nga data e caktuar e pagesës sipas afateve të marrëveshjes, gjatë së cilës pagesa nuk konsiderohet e vonuar për qëllim të aplikimit të kamatëvonesës. Në qoftë se pagesa e kështi nuk realizohet brenda periudhës së tolerimit, pagesa e kështi do të konsiderohet në vonesë dhe huadhënësi do të ngarkojë kamatëvonesën. Në këtë rast kamatëvonesa aplikohet duke filluar nga data e fillimit të periudhës së tolerimit. Data e fillimit të vonesës së pagesës për muajin aktual duhet të jetë data pasuese e datës së përfundimit të periudhës së tolerimit. Numri i ditëve në vonesë për çdo pagesë të vonuar do të llogaritet për të gjitha ditët kalendarike në periudhën kontabël, e cila nënkupton periudhën nga data e parë e vonesës deri tek data paraprake e datës efektive të pagesës së kryegjësë në vonesë.
10.4 Përllogaritja e normës së kamatëvonesës. Nëse huamarrësi vonon në përmbushjen e detyrimit sipas marrëveshjes kreditor, ai do të paguajë kamatëvonesën në shumën e kryegjësë së vonuar sipas normës së përcaktuar në këtë marrëveshje kreditor dhe kushtet specifike. Llogaritja e normës së kamatëvonesës do të jetë norma vjetore (Nv), e cila përbëhet nga norma referente e rritur për 8 pikë përqindje normë fikse. Normën referente do ta publikojë BQK çdo gjashtë muaj.
10.5 Metoda e përllogaritjes së kamatëvonesës. Kamatëvonesa do të përllogaritet për shumën e kryegjësë në vonesë përgjatë numrit të ditëve kalendarike në vonesë varësisht nga numri i ditëve kalendarike të vitit (365 ose 366), duke aplikuar formulën matematikore në përputhje me rregulloren për kamatëvonesën e instrumenteve kreditore e miratuar nga BQK me datën 29.08.2019. Në bazë të normave referente aktuale të publikuara të BQK-se kamat vonese ditore është 0.0328%.
10.6 Kamatëvonesa e llogaritur për secilën periudhë kontabël (zakonisht mujore) i shtohet kamatëvonesës së përllogaritur, kështu që, kamatëvonesa e përllogaritur është shuma totale e të gjitha kamatëvonesave të llogaritura për të gjitha pagesat në vonesë të kryegjësë deri me ditën e llogaritjes.
10.7 Huadhënësi nuk mund të aplikojnë normë më të lartë të kamatëvonesës se sa niveli i përcaktuar i kamatëvonesës me anë të kësaj marrëveshje kreditore.
10.8 Nëse norma e kamatëvonesës e përcaktuar në marrëveshjet e instrumenteve kreditore të aprovuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregullores se kamatëvonesave është më e favorshme për huamarrësin se sa norma e përcaktuar me rregulloren e kamatëvonesave, Huadhënësi në rast të aplikimit të kamatëvonesës duhet të aplikojnë normën e kamatëvonesës të përcaktuar në ato marrëveshje të kreditore edhe në vonesat e ndodhura pas hyrjes në fuqi të rregullores se kamatëvonesave.

11. Kryerja e Pagesave

11.1 Çdo pagesë që duhet t'i paguhet Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshje, do të bëhet nga Huamarrësi në çdo Degë ose llogari bankare të Huadhënësit ose ndonjë nga partnerët e autorizuar të Huadhënësit të listuara në faqen e internetit dhe/ose në çdo Degë, në monedhën e miratuar për shumën e huasë, interesin dhe detyrimet. Çdo pagesë që duhet të paguhet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshje do të konsiderohet si e paguar në mënyrë efektive tek Huadhënësi, pasi fondet të jenë pranuar në Degë, në një partner të autorizuar ose të kredituar në ndonjë llogari bankare të Huadhënësit dhe që do të jenë të disponueshme për tërheqje nga Huadhënësi.
11.2 Çdo shpenzim bankar, tatim apo kosto administrative që lidhet me çdo disbursim të bërë nga Huadhënësi, do të paguhet nga Huamarrësi.
11.3 Huamarrësi me këtë pranon dhe pajtohet që nga çdo shumë që duhet paguar/disbursuar Huamarrësit, Huadhënësi mund të refuzojë dhe të vendosë ndonjë nga detyrimet dhe/ose ndonjë shumë tjetër që Huamarrësi i detyrohet Huadhënësit.
11.4 Në rast se pagesat e arritura për pagesë duhet të bëhen nga një palë e tretë e autorizuar nga Huamarrësi, Huamarrësi duhet të informojë palën e tretë që kryen pagesat në mënyrën e duhur në lidhje me huanë dhe pagesën përpara se pala tjetër e tretë të kryejë pagesat e duhura dhe të pagueshme për Huadhënësin, duke treguar detajet e nevojshme për të kryer pagesën për obligimet që dalin nga Marrëveshja e Huasë.
11.5 Kryerja e pagesës do të bëhet përmes radhitjes së mëposhtme:
11.5.1 kamatëvonesa e kontraktuar dhe çdo shpenzim tjetër që rrjedh nga kjo Marrëveshje;
11.5.2 interesi i rregullt;
11.5.3 shuma kryesore (kryegjëja)

12. Llogaria Online

12.1 Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, Huamarrësi hap dhe mban një Llogari Online të Konsumatorit ("Llogaria Online") me Huadhënësin, në përputhje me kushtet dhe afatet e aplikueshme për Llogarinë Online ("Afatet dhe Kushtet e Llogarisë Online").
12.2 Llogaria Online do të jetë e qasshme në mënyrë elektronike në ëebsite në pajtim me Afatet dhe Kushtet e Llogarisë Online.
12.3 Llogaria Online do të shërbejë si një platformë për Huamarrësin për të menaxhuar marrëdhëniet e tij/saj me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje, e cila përfshin, marrjen e informacionit mbi bilancin e detyrimeve dhe detajet e transaksioneve të fundit, duke bërë ndryshime në të dhënat e Huamarrësit, llogaritë dhe profilin, bërjen dhe marrjen e Njoftimeve për/nga Huadhënësi, bërjen e aplikacioneve për disbursime dhe ndryshime në kushtet e huasë, etj. Llogaria Online nuk do të shërbejë si sistem pagesash, përveç nëse lejohetme një licencë specifike të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
12.4 Të dhënat e Llogarisë Online do të trajtohen nga Huadhënësi në përputhje me Rregulloren e Privatësisë në fuqi.

13. Përfaqësimet e Huamarrësit dhe Garancitë

13.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Huamarrësi paraqet dhe garanton Huadhënësin si vijon:
13.1.1 Të gjitha informatat/dokumentet e paraqitura nga Huamarrësi për miratimin e kërkesës fillestare të huasë ndaj Huadhënësit, si dhe ato që duhet të dorëzohen në lidhje me ndonjë vlerësim të mëvonshëm të kredisë që mund të bëhet nga Huadhënësi, janë/do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, që nga data e dorëzimit të tyre me Huadhënësin.
13.1.2 Huamarrësi ka marrë nga Huadhënësi të gjitha shpjegimet e nevojshme përmes Informacionit Parakontraktormbi afatet dhe kushtet e zbatueshme për këtë Marrëveshje.
13.1.3 Kjo Marrëveshje është lidhur lirshëm nga Huamarrësi dhe përbën obligime detyruese dhe të zbatueshme për Huamarrësin, pasardhësit e tij dhe personat e lejuar.
13.1.4 Në datën e nënshkrimit, Huamarrësi nuk është nën përmbarimin e detyrueshëm dhe/ose procedurat e falimentimit dhe nuk ka gjasa që këto procedura të ndodhin dhe Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për ndodhjen e ndonjë ngjarjeje që mund të çojë në rrezik të fillimit të përmbarimit të detyrueshëm dhe/ose procedurave të falimentimit.
13.1.5 Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për ndodhjen e çdo ngjarjeje që mund të çojë në rrezikun e një humbjeje të konsiderueshme të të ardhurave të Huamarrësit, të deklaruara në kërkesën fillestare tek Huadhënësin si dhe ato që duhet të dorëzohen në lidhje me çdo vlerësim të mëvonshëm të kredisë që mund të bëhet nga Huadhënësi.

13.1.6 Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për çdo ndryshim të detajeve të tij të përcaktuara më lart në këtë Marrëveshje.
13.1.7 Huamarrësi pranon dhe autorizon përdorimin dhe përpunimin e të dhënave personale nga Huadhënësi gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje.
Huamarrësi jep pëlqimin dhe autorizimin e tij që Huadhënësi të ruajë, të përpunojë, analizojë dhe të përdorë të dhënat personale të mbledhura për qëllimet e kësaj Marrëveshje, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Pëlqimi i dhënë vlen për të gjitha Marrëveshjet e Huasë që do të disbursohen në të ardhmen dhe të cilat udhëheqen nga Kontrata me Kushte të Përgjithshme. Pëlqimi i dhënë nga Huamarrësi vlen për përdorimin dhe përpunimin e të dhënave të tij/saj personale, si dhe të ketë qasje në raportet e kredive në Regjistrin e Kredive në BQK, me qëllim të procesimit, mirëmbajtjes, vazhdimit dhe ndryshimit të kushteve të kësaj huaje si dhe të gjitha Marrëveshjeve apo Shtojcave që dalin nga kjo Marrëveshje që do të lëshohen në të ardhmen dhe që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshje, përfshirë aplikimin online për hua; për mbledhjen e informacioneve financiare rreth tij në shoqëritë e mbledhjes së borxheve, zyrat e kreditit dhe institucione tjera të Republikës së Kosovës; për dërgimin dhe pranimin e porosive telefonike SMS nga Huadhënësi apo palët e treta të autorizuara nga Huadhënësi, oferta për kredi, me të cilat do të njoftohet për gjendjen e huas së tij/saj; Huamarrësi pajtohet që të gjitha informatat e mbledhura gjatë procesit të huadhënies, varësisht prej nevojës dhe vetëm deri në masën e domosdoshme për zbulim, mund t'i ndajë me kontraktorët e tij të jashtëm, siç janë: këshilltarët e jashtëm ligjor, këshilltarët financiar, tatimor, auditorët, këshilltarët ligjorë, si dhe me çfarëdo kontraktori tjetër të jashtëm, përderisa një zbulim i tillë është i domosdoshëm dhe me kusht që pranuesi i këtyre të dhënave të obligohet për konfidencialitet të plotë për këto të dhëna.
13.1.8 Në mënyrë që të dhënat e ofruara nga Huamarrësi të verifikohen më mirë dhe saktë, Huamarrësi me rastin e aplikimit për hua, pajtohet që të ofroj numrin kontaktues të një personi kontaktues, i cili do të verifikoj të dhënat e ofruara nga Huamarrësi dhe për këtë Huamarrësi, do ta njoftoj personin kontaktues për këtë. Me dhënien e informacionit për personin kontaktues Huamarrësi konfirmon që personi kontaktues është informuar për faktin se të dhënat e tij/saj personale i ofrohen Huadhënësit për qëllimin e kontaktimit të Huamarrësit në rast se Huamarrësi nuk mund të arrihet dhe të gjindet vendbanimi i tij/saj dhe vonesa të mëtejshme të pagesave apo shkelje të tjera Marrëveshja mund të rezultojë në dëm të konsiderueshëm të historikut të huasë së Huamarrësit. Huamarrësi ka njoftuar personin kontaktues se të dhënat e tij/saj janë mbledhur nga Huadhënësi dhe se të dhënat e përmendura do të fshihen nga Huadhënësi me kërkesë të parë të personit kontaktues dhe se Huadhënësi do të veproj në përputhje të plotë me Rregulloren e Privatësisë së Huadhënësit për mënyrën dhe nivelin e përdorimit të dhënave personale konform Ligjit për Mbrotjen e të Dhënave Personale nr. 06/L-082.
13.1.9 Huamarrësi është njoftuar dhe pajtohet me Rregulloren e Privatësisë së Huadhënësit për mënyrën dhe nivelin e përdorimit të dhënave personale konform Ligjit për Mbrotjen e të Dhënave Personale nr. 06/L-082.

14. Gjuhët dhe Njoftimet

14.1 Gjuha e kësaj Marrëveshje është gjuha Shqipe, dhe të gjitha njoftimet, kërkesat, deklaratat, çertifikatat ose dokumentet apo komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara nën ose të bëra ndryshe në lidhje me këtë Marrëveshje ("Njoftimet") duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe do të bëhen me shkrim.
14.2 Huadhënësi mund të dorëzojë Njoftimet në adresën fizike të deklaruar nga Huamarrësi këtu më lartë në këtë Marrëveshje, në adresën e emailit të Huamarrësit ose në adresa ose kontakte të tjera që Huamarrësi mund të caktojë me njoftim nga koha në kohë. Huadhënësi gjithashtu mund të kryejë Njoftime për Huamarrësin duke postuar mesazhe elektronike në Llogarinë Online.
14.3 Huamarrësi mund të dorëzojë Njoftimet në adresën fizike të Huadhënësit, ose dërgimin e mesazheve elektronike në Llogarinë Online.
14.4 Çdo njoftim i paraqitur nga Huadhënësi do të konsiderohet se është pranuar nga Huamarrësi, menjëherë pas dorëzimit me dërgimin e mesazhit, ose me hyrjen në Llogarinë Online.
14.5 Çdo njoftim i paraqitur nga secila Palë në adresën fizike të palës tjetër nëpërmjet shërbimit postar, do të konsiderohet se ka efekt në datën që është dy ditë pas datës së dërgimit të njoftimit me shërbim postar të regjistruar ose të çertifikuar, pavarësisht të momentit aktual të pranimit.
14.6 Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Njoftim i dorëzuar me mjete të tjera të komunikimit, i cili vërtetohet se është bërë/pranuar në mënyrë efektive, nuk do të jetë i pavlefshëm sepse është bërë ndryshe nga sa më sipër.

15. Përfundimi dhe Pasojat

15.1 Shkelja e kësaj Marrëveshje nga Huamarrësi për pasoj do të ketë aplikimin e kamatëvonesave të kontraktuara cekur në nenin 10 të kësaj marrëveshje kreditore.
15.2 Shkelja materiale e kësaj Marrëveshje nga Huamarrësi do të përbëjë një "rast të Mospërmbushjes" sipas kësaj Marrëveshje.
15.3 Në rast të Mospërmbushjes, Huadhënësi mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke lëshuar një njoftim me shkrim ("Njoftimi i Ndërprerjes") Huamarrësit, pas skadimit të afatit të specifikuar në një njoftim me shkrim të korrigjimit ("Njoftimi i Korrigjimit") (e cila periudhë duhet të jetë e arsyeshme, por jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë):
15.3.1 Në rast se rasti i Mospërmbushjes mbetet pa u përmirësuar nga Huamarrësi gjatë periudhës së tillë, ose
15.3.2 Në rast se rasti i Mospërmbushjes nuk mundë të përmirësohet, nëse gjatë periudhës së tillë një kompensim adekuat është rënë dakord në mes të Palëve.
15.4 Një njoftim për nderprerje i lëshuar nga Huadhënësi në perputhje me këtë Nen do të këtë efekt të menjëhershëm të ndërprerjes së kësaj Marrëveshje, nëse është e nevojshme mund të jetë një datë të mëvonshme por që specifikohet në Njoftimin e Ndërprerjes.
15.5 Pa paragjykuar sa më sipër, Palët shprehimisht pranojnë që Huadhënësi do të ketë të drejtë ta ndërpresë menjëherë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim tek Huamarrësi në këto raste:
15.5.1 Huamarrësi nuk paguan shumat e papaguara sipas kësaj Marrëveshje; ose
15.5.2 Huamarrësi është në kundërshtim me përfaqësimet dhe garancionet e tij të Nenit 13 të kësaj Marrëveshje; ose
15.5.3 Huamarrësi ka pësuar një humbje të konsiderueshme/zvogëlim të të ardhurave të deklaruara në kërkesën për kredi dhe/ose në çdo vlerësim të mëvonshëm të kredisë që mund të bëhet nga Huadhënësi;
15.5.4 Huamarrësi nuk pranon asnjë përditësim që mundëson Huadhënësi t'i ndryshojë efektvisht kushtet e Llogarisë Online dhe Rregulloren e Privatësisë;
15.5.5 Nëse Huadhënësi nuk mund t'i japë Huamarrësit më hua, në rast se llogaria bankare e Huamarrësit është bllokuar ose mbyllur dhe transferimi i mjeteve nuk mund të ekzekutohet, me kusht që Huamarrësi ka deshtuar të hap një llogari të re bankare dhe të njoftojë me kohë Huadhënësin nëpërmjet Njoftimit;
15.5.6 Nëse Huadhënësi ka përcaktuar që Huamarrësi është bërë një person i ekspozuar politikisht; 15.5.7 Nëse
Huadhënësi është shpallur i paaftë për të vepruar me kapacitet të plotë ligjor dhe veprimi.
15.6 Huamarrësi mundë të nderprejë këtë Marrëveshje përmes Njoftimit për Ndërprerje, në rast të zvogëlimit të Limitit sipas Nenit 5.2, të një refuzimi për Disbursim të shumave sipas Nenit 6.3 apo brenda periudhës së përmendur në Nenin 17.3 të kësaj Marrëveshje, aj/ajo zgjedh të mos e pranoj ndryshimin e njoftuar nga Huadhënësi sipas Nenit 17.3 të kësaj Marrëveshje brenda kohës së përmendur në Nenin 17.3.
15.7 Të dy Palët me vullnet të plotë mundë të ndërprenë këtë Marrëveshje pa dhënë ndonjë arsye, duke dorëzuar me shkrim Njoftimin për Ndërprerje tek pala tjetër.
Huamarrësi duhet ta dorëzoj Njoftimin për Ndërprerje se paku 30 (tridhjetë) ditë më herët, ndërsa Huadhënësi së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë më herët.
15.8 Huamarrësi nuk mundë të nderprejë këtë Marrëveshje jashtë asaj që është caktuar më lartë në këtë Nen.
15.9 Në rast të nderprerjes se kësaj Marrëveshje, Shumat e Pashlyera të huazuara nga Huamarrësi do të përshpejtohen dhe bëhen të pagueshme nga Huamarrësi brenda 30 (tridhjetë ditëve) të datës efektive të ndërprerjes, pavarësisht të ndonjë afati kohor të rënë dakord për pagesë.
15.10 Ndërprerja e kësaj Marrëveshje është pa paragjykim të dispozitave të Neneve 10, 11, 4, 16, 18, 19 dhe 20 të kësaj Marrëveshje të cilët do të mbeten për ndërprerje të kësaj Marrëveshje.

16. Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni

16.1 Kjo Marrëveshje do të udhëheqet nga ligjet të Republikës së Kosovës.
16.2 Secila Palë këtu në mënyrë pajtohet që çdo veprim, kërkesë, apo procedim, përfshirë çdo masë të brendshme të mbrojtjes që del jashtë apo në lidhje me këtë Marrëveshje ("Mos-marrëveshje") duhet të dorëzohet dhe përfundimisht të zgjidhet nga gjykata kompetente të Republikës së Kosovës.
16.3 Palët me tutje pajtohen që fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhje të Mos-marrëveshjes nuk do të përbej një bazë ligjore për pezullimin e kësaj Marrëveshje dhe nuk do të liroj Huamarrësin nga obligimet e ndërmarra këtu.

17. Terësia e MarrëveshjesNdryshimet dhe Njoftimet

17.1 Kjo Marrëveshje, duke përfshirë preambulat e saj dhe dokumentet e bashkangjitura, përbën të gjithë kuptimin e Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje dhe zëvendëson të gjitha Marrëveshjet e mëparshme, Marrëveshjet, qoftë me gojë ose me shkrim të Palëve në lidhje me të njëjtën çështje.
17.2 As kjo Marrëveshje dhe as ndonjë dispozitë e saj nuk mund të ndryshohet ose modifikohet, përveç në bazë të një Marrëveshje me shkrim (e cila përfshin edhe Marrëveshjet në formë elektronike) të lidhur nga Palët dhe çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit (përveç nëse një datë efektive më vonë është rënë dakord) nga të dy Palët.
17.3 Pa rënë ndesh me sa më sipër, Palët bien dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën të ndryshojë Interesin e zbatueshëm për një shumë tashmë të disbursuar, me anë të njoftimit tek Huamarrësi, nëse pas Disbursimit Huadhënësi përditëson Listën e Interesit dhe Detyrimeve, (i) një ndryshim i tillë nuk do të hyjë në fuqi për Huamarrësin përpara skadimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e Njoftimit të Huadhënësit dhe (ii) gjatë 30 (tridhjetë) ditëve, Huamarrësi do të ketë të drejtë ta ndërpres këtë Marrëveshje, pa dënime, në pajtim me Nenin 15.5 të kësaj Marrëveshje.
17.4 Nëse Huamarrësi nuk i dorëzon Huadhënësit një Njoftim me Shkrim në pajtim me Nenin 15.5 të kësaj Marrëveshje brenda periudhës prej 30 (tridhjetë) ditësh të përcaktuar më lart, atëherë ndryshimi i Interesit i Njoftuar nga Huadhënësi fillon të zbatohet si formë e skadimit të afatit të lartë përcaktuar.
17.5 Huamarrësi obligohet që ta njoftojë Huadhënësin me shkrim për çdo ndërrim të llogarisë bankare, numrin e telefonit mobil, adresën, e-mailin, dhe çdo të dhënë tjetër, me shkrim në mënyrë që ndryshimi të jetë efektiv. Njëjtë vlen dhe për Huadhënësin lidhur me ndryshimet e Afateve dhe Kushteve të Llogarisë Online. Huadhënësi nuk do të jetë përgjegjës në asnjë rast, nëse Huamarrësi ndryshon të dhënat personale dhe çfarëdo të dhëne tjetër me rëndësi dhe për këtë nuk ka njoftuar Huadhënësin.

18. Cedimi

18.1 Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje nuk mund të cedohen dhe t'i transferohen një personi të tretë pa pëlqimin paraprak të Huadhënësit që ka pranuar personin e tretë si huamarrës të ri, i cili pëlqim do të jetë në diskrecionin e Huadhënësit, nëse Huamarrësi është vdekur, detyrimi për të shlyer shumat e papaguara do t'i caktohet trashëgimtarëve të tij/saj ligjorë, në perputhje me ligjin.

18.2 Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje të Huasë, Huamarrësi në këtë mënyrë jep në mënyrë të pakthyeshme pëlqimin e tij të pakushtëzuar për Huadhënësin që të cedojëdhe transferojë këtë Marrëveshje dhe çdo të drejtë dhe detyrim të saj në vijim, një personi të tretë, i cili do të bëhet Huadhënës i ri, në një Njoftim me shkrim për Huamarrësin për caktimin e ndodhur dhe për identitetin e Huadhënësit të ri. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje të Huasë, Huamarrësi në këtë mënyrë jep në mënyrë të pakthyeshme pëlqimin e tij të pakushtëzuar për Huadhënësin për të dhënë të drejta, në çdo formë, në favor të palëve të saj të financimit, për kërkesat e pagesës dhe të arkëtueshmet e tjera të Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshje.

19. Titulli Ekzekutiv

19.1 Kjo Marrëveshje është një akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jo-bankare dhe si e tillë përben një titull ekzekutiv të detyrueshëm për Huamarrësin.

19.2 Nëse Huamarrësi dështon të paguaj shumat e huasë sipas kësaj Marrëveshje, Huadhënësi do të ketë të drejtë të fillojë procedurat e detyrueshme të përmbarimit kundër Huamarrësit, duke mos i paragjykuar të drejtat e Huadhënësit për të vazhduar me mjetet e tjera në dispozicion sipas kësaj Marrëveshje ose ligjeve në fuqi.

20. Ankesa apo njoftime

20.1 Duke u mbështetur në ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë, klienti ka të drejtë dhe është në dijeni se nëse nuk është i kënaqur me shërbimet e ofruara nga Institucioni mund të parashtroj ankesë tek Kujdesi për Klientë i cili funksionon në kuadër të Institucionit. Ankesa fillestare mund të parashtrohet gjatë kontaktit me zyrtarët e Monego sh.p.k të cilët do të mundohen që ankesë tuaj ta zgjidhin menjëherë, në mënyrë që ankesa e juaj të zgjidhet sipas dakordimit të dyja palëve.Në çoftëse nuk jeni të kënaqur me trajtimin e ankesës atëherë atë mund ta parashtroni duke kontaktuar numrin pa pagesë 0800 777 88, përmes email adresës kujdesi@monego.com, duke plotësuar formularin e ankesës në njërën prej degëve, përmes adresës postare në Rr. Mbreti Zog I, Nr.2, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës ose duke u paraqitur personalisht në të njëjtën adresë. Ankesat do të shqyrtohen në afatin prej pesëdhjetë (15) ditëve (pune) nga data e pranimit të saj, për raste më të ndërlikuara ky afat mundet të shtyhet deri në tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit, për shtyrjen e këtij afati parashtruesi i ankesës do të njoftohet në afatin sa më të shkurt. Për raste të veçanta të cilat për shkak të ndërlikueshmërisë së tyre kërkojnë kohën shtesë, parashtruesi do të njoftohet për arsyet e shtyrjes dha afatin maksimal kur përgjigjja për rastin do t'i dorëzohet. Përgjigja në ankesën e parashtruar do të jepet me shkrim nëpërmjet lerës, në formë elektronike ose përmes telefonit nëse këtë e preferon parashtruesi i ankesës. Përgjigja do të dorëzohet parashtruesit të ankesës në njërën prej gjuhëve zyrtare në Kosovë, ose në gjuhën me të cilën është lidhur marrëveshja mbi produktin apo shërbimin, i cili është objekt i ankesës. Nëse klienti nuk do të jetë i kënaqur me trajtimin e ankesës nga Institucioni, ka të drejtë të ankesës në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Gjykatës, ndonjë institucioni publik apo të shikoj për metoda për zgjidhjen e alternative të kontesteve, nëse kjo është e aplikueshme. Ankesa nuk i nënshtrohet asnjë tarife apo shpenzimi, ose kushti për përdorimin e ndonjë formati të veçantë.

21. Të Ndryshme

21.1 Asnjë heqje dorë nga ose në emër të Huadhënësit të ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshje, do ta lirojë Huamarrësin nga përmbushja e plotë e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, përveç në masën e tillë të drejtpërdrejtë është bërë në shkrim nga Huadhënësi.

21.2 Çdo mos ushtrim i të drejtave kontraktuale apo ligjore që i takojnë Huadhënësit nuk do të konsiderohen heqje dore nga kjo e drejtë dhe nuk do të ndikojë në aftësinë e Huadhënësit që më pas ta ushtrojë këtë të drejtë ose të ndjekë ndonjë zgjidhje.

21.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshje konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Marrëveshje nuk do të ndikohen ose dëmtohen në asnjë rast. Dispozita e pavlefshme përshtatshmërisht do të zëvendësohet automatikisht nga një dispozitë tjetër e Marrëveshjes që reflekton vullnetin e palëve.

21.4 Huamarrësi ka të drejtë të paraqesë ankesa tek Huadhënësi lidhur me përmbushjen e të drejtave ose detyrimeve të të dy Palëve sipas kësaj Marrëveshje ose ligjit të aplikueshëm. Ankesat e tilla nga Huamarrësi dorëzohen me shkrim dhe dërgohen me postë të regjistruar në adresën e Huadhënësit. Huadhënësi merr përsipër t'i përgjigjet me shkrim kësaj ankese të Huamarrësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e ankesës.

21.5 Palët në këtë rast kanë bërë që kjo Marrëveshje të ekzekutohet në 2 (dy) ekzemplarë apo në mediumin e qëndrueshëm, një për secilën palë dhe të dorëzohet që nga data e shkruar më lartë.

21.6 Autoriteti mbikëqyrës kompetent i Huadhënësit është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me seli në Rr. Garibaldi, nr. 33, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Huadhënësi:

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Huamarrësi:

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Huadhënësi

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Huamarrësi:

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

ANEKSI 1 – Marrëveshja e Pengut

MARRËVESHJA E PENGUT Sendi i luajtshëm i lënë peng nga Huamarrësi

1. Zotimi

Sipas Nenit 19 të kësaj Marrëveshje, pasuria në vijim, e cila nuk konsiderohet si pasuri e paluajtshme, dhe të gjitha të drejtat, letrat me vl
Huamarrësi:

1) Huamarrësi pajtohet të krijojë/regjistrojë një peng (zotim) në të gjitha llogaritë bankare të hapura dhe të ardhshme në të gjitha bankat
Huamarrësit.

2. Regjistrimi i Pengut

Huamarrësi pajtohet që Huadhënësi do të regjistrojë pengun (zotimin) e lartpërmendur, në Regjistrin e Pengut (Zotimit) në Ministrinë e T

3. Nuliteti i Pjesshëm

Në rast se një ose më shumë nga dispozitat e përmbajtura këtu, për çfarëdo arsye, do të konsideroheshin të pavlefshme, të paligjshme os
kjo pavlefshmëri, paligjshmëria ose pazbatueshmëria nuk do të ndikojë në asnjë dispozitë tjetër të këtij Aneksi.

4. Efekti Detyrues

Ky Aneks do të jetë i detyrueshëm dhe i pavlefshëm për përfitimin e Palëve, trashëgimtarët e tyre, trashëgimtarët, përfaqësuesit persona

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët në këtë rast kanë bërë që ky Aneks të ekzekutohet në 2 (dy) ekzemplar, një për secilën palë dhe të dorëzohet

---

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët në këtë rast kanë bërë që kjo Marrëveshje të ekzekutohet në 2 (dy) ekzemplarë, një për secilën palë dhe të dorëzohet që nga data e shkr

Për Huadhënësin:

Për Huadhënësin:

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Huamarrësi:

Huamarrësi:

_____

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Përfaqësuesi i Autorizuar

Huamarrësi përmes kësaj shprehimisht deklaron se aj/ajo është në dijeni të plotë dhe në menyrë specifike aprovon dispozitat e Neneve 5.2, 6.3, 10, 11, 15, 16, 17.3, 18dhe19të kësaj Marrëveshje. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Huamarrësi përmes kësaj deklaron se aj/ajo është në dijeni të plotë dhe pranon Programin e Interesit dhe Detyrimeve, Kushteve të Llogarisë Online dhe Politikës së Privatësisë së Huadhënësit, si në fuqi në Datën e Nënshkrimit. Çdo ndryshim në këto dokumente duhet të njoftohet Huamarrësi për pelqim sipas kësaj Marrëveshje.

Huamarrësi:

_____

1

Nuk mund ta paguani kredinë me kohë?

2

Atëherë, zgjate datën e kthimit të kredisë prej 7-30 ditë!

3

Kyçuni në profilin tuaj personal për të parë koston e zgjatjes!

4

Bëni pagesën për "Zgjatje të datës së pagesës", kredinë paguajeni më vonë!